



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË  
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-MALLRA**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROKURIMIT:**

**“Blerje pajisje kompjuterike për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

Fotokopjuese – 30121100-4; Kompjutera portativ – 30213100-6; Kompjutera desktop – 30213300-8; Pajisje të ndryshme kompjuterike – 30236000-2; Pajisje kompjuterike – 30237200-1; Skanera – 38520000-6;

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**14,647,241 (katërmbëdhjetë milion e gjashtëqind e dyzet e shtatë mijë e dyqind e dyzet e një) lekë pa TVSH, i ndarë si më poshtë:**

Për Rektoratin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë: 4,405,805 (katër milion e katërqind e pesë mijë e tetëqind e pesë) lekë pa TVSH.

Për Fakultetin e Mjekësisë: 4,165,549 (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e dyzet e nëntë) lekë pa TVSH.

Për Fakultetin e Mjekësisë Dentare: 1,955,439 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e katërqind e tridhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

Për Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike: 4,120,448 (katër milion e njëqind e njëzet mijë e katërqind e dyzet e tetë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*Formulari i ofertës sipas Shtojcës 1;*

*Lista e çmimeve të artikujve sipas Shtojcës 2;*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 40, pika 7, gërma “ç” (sipas Shtojcës 1 dhe 2 të DST).

*Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

*Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

**Sipas Shtojcës 7 të DST**

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos në zbatim të nenit 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 40, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar**

Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit. Në këtë kontekst, operatorët ekonomikë duhet të tregojnë se i përmbushin kushtet e mëposhtme:

**2.2.1.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim, për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit i kontratës objekt prokurimi**. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar

nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitetin financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

- 2.2.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet e fundit financiare 2020, 2021, 2022, që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Shënim:** Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr. 10091 datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

- 2.2.3.** Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar.

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale.

Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

## 2.3 Kapaciteti teknik:

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

- a) Operatori ekonomik për përvojën e mëparshme duhet të paraqesë kontrata të shoqëruara me vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara të nënshkruara nga të dyja palët.

ose

- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

**2.3.2.** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatën “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë” ISO 9001:2015, ose ekuivalente, (të përkthyer në shqip dhe të noterizuar) të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të artikujve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të LPP, të pikës 1, nenit 44, të VKM-së nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë sipas objektit të kësaj kontrate. Certifikimi **ISO 9001:2015 është** standarti më i njohur që është publikuar ndonjëherë në nivel ndërkombëtar. Ai përcakton kërkesat për një sistem menaxhial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të çertifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. Kjo certifikatë i ofron siguri AK që OE ofrojnë produkte dhe shërbime të qëndrueshme.

**2.3.3.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog/ët ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit për të gjitha produktet. Në to duhet të jenë pasqyruara produktet dhe specifikimet teknike të tyre (të markuara me ngjyrë në mënyrë që të identifikohen). Katalog/ët ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit, duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të tregojnë lehtësisht se cilit produkt dhe cilit prodhues i përkasin.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 6/b e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë që malli që ata disponojnë dhe tregtojnë është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit.

**2.3.4.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim ose marrëveshje bashkëpunimi nga firma prodhuese, ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi (duke vërtetuar lidhjen prodhues dhe distributor i autorizuar) për mallrat e sipërpërmendura. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që janë të autorizuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për tregtimin e mallrave dhe kryerjen e shërbimeve dhe riparimeve në rast defekti, brenda periudhës së garancisë. Në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor ka garanci që po hyn në marrëdhënie kontraktuale me një operator ekonomik serioz në treg, që ka autorizim për kryerjen e aktivitetit objekt prokurimi dhe siguron lidhjen përkatëse me subjektin që ka dhënë autorizimin.

**2.3.5.** Operatori ekonomik, duhet të realizojë trajnimin e specialistëve IT të secilës njësi shpenzuese lidhur me vendosjen në punë të secilës pajisje, ndaj duhet të ketë të punësuar ose me kontratë angazhimi, punonjësit si më poshtë:

- a) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për trajnimin e stafit teknik për instalimin dhe konfigurimin e pajisjeve elektronike “Trajner i certifikuar për produktet Microsoft”, ose ekuivalent.
- b) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar nga prodhuesi i printerave dhe fotokopjeve të ofruara.

Për të vërtetuar kualifikimet, eksperiencën e punës dhe profilet e stafit të punonjësve si më sipër, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin provues, si më poshtë:

- CV;
- Kontratë pune ose kontratë angazhimi me operatorin ekonomik.
- Listëpagesat sipas formularit E-Sig 025/a për muajin e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi për punonjësit që i ka të siguruar me kontratë pune.

*Kriteri 2.3.5 do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8, pjesa III, pika B të DT (Duke vendosur emrat e secilit). Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga*

OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit paraparak të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ b,c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për trajnimin e specialistëve IT të secilës njësi shpenzuese. Konkretisht:

Për kriterin në pikën a), duke qenë se pjesë e prokurimit janë UPS, fotokopje, printera, skanera, kompjutera, laptopë, router, switch, dhe projektorë është e nevojshme që OE të ketë në stafin e tij të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në nivel teknik për instalimin dhe konfigurimin e pajisjeve elektronike “Trajner i certifikuar për produktet Microsoft”, ose ekuivalent për të mundësuar trajnimin e stafit për instalimin, konfigurimin dhe vendosjen në gjendje pune me funksionalitet të plotë, sipas përcaktimeve të specifikimit teknike, të të gjithë pajisjeve të sipërpërmendura që përdorin zgjidhjet e produkteve Microsoft ose të ngjashëm. Duke qenë se teknologjia po avancohet çdo ditë dhe me hapa shumë të shpejtë shihet e nevojshme që një specialist në nivel trajneri, të jetë i nevojshëm për këtë procedurë. Kjo do t’i sigurojë AK-së informacionin e fundit, trajnimin mbi instalimet, konfigurimet për zgjidhjet e produkteve Microsoft ose të ngjashëm. Niveli i kërkuar në këtë pikë garanton profesionalizëm dhe njohuri teknike të avancuara specifike në nivel trajneri për të ofruar trajnimin e stafit të Autoritetit Kontraktor me zgjidhjet e produkteve Microsoft ose të ngjashëm, të pajisjeve të sipërpërmendura, si dhe për të suportuar/mirëmbajtur ato gjatë kohës së garancisë.

Për kriterin në pikën b), duke qenë se pjesë e prokurimit janë fotokopje dhe printera/skanera, është e nevojshme që OE të ketë në stafin e tij të paktën 1 (një) specialist të certifikuar nga prodhuesi në nivel teknik për të mundësuar trajnimin e stafit për instalimin, konfigurimin dhe vendosjen në gjendje pune me funksionalitet të plotë, sipas përcaktimeve të specifikimit teknike, të të gjithë pajisjeve të sipërpërmendura. Niveli i kërkuar në këtë pikë garanton profesionalizëm dhe njohuri teknike të avancuara specifike për instaluar dhe për të trajnuar stafin e Autoritetit Kontraktor për pajisjet e sipërpërmendura, si dhe për të suportuar/mirëmbajtur ato gjatë kohës së garancisë. Pikërisht ky specialist do mundësojë trajnimin teknik të stafit për të siguruar mirëpërdorimin dhe për të rritur jetëgjatësinë e pajisjeve të lartpërmendura.

**2.3.6.** Operatori ekonomik duhet të deklarojë që merr përsipër transportin e pajisjeve pranë ambjenteve të secilës njësi shpenzuese, brenda afatit të parashikuar.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, neni 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se do të kryejnë transportin e mallrave objekt prokurimi në adresën e secilës njësi shpenzuese.

**2.3.7.** Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë se mallrat objekt prokurimi janë të reja, të papërdorura (të paketuara në kuti nga prodhuesi) si dhe në përputhje me specifikimet teknike.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të



deklarojnë se mallrat që do të furnizohen janë të reja (për të shmangur dorëzimin e produkteve të përdorura) si dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara për secilën pajisje.

**2.3.8.** Operatori Ekonomik duhet të deklarojë garancinë e mallrave objekt prokurimi e cila duhet të jetë sipas afatit të përcaktuar në specifikimet teknike. Gjatë periudhës së garancisë ofertuesi duhet të sigurojë riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin pa pagesë konform specifikimeve teknike.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër garancinë e mallrave objekt prokurimit në përputhje me afatin e përcaktuar në specifikimet teknike. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të kryhet riparimi, mirëmbajtjen dhe shërbimin pa pagesë.

**Shënim:** Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike<sup>1</sup>. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.”, sjellim ne vemendje se:

- Disponimi i punonjësve dhe i mjeteve/pajisjeve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit (shtojca 8) gjatë fazës së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t'i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit për disponimin e punonjësve, mjeteve/pajisjeve do të jetë kusht s'kualifikimi.

- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s'kualifikimi.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

**Specifikimet teknike janë marrë nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit të vlefshme për periudhën 1 Janar 2023 – 31 Dhjetor 2024 (Bashkëngjitur DST)**

Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me pjesën teknike janë hartuar nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Blerje pajisje kompjuterike për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”**, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim Znj. Ilva Ymeraj.

**Njësia e Prokurimit:**



